



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Komunitete
Z./Znj. _____

Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Qeverisje Lokale dhe nenit 42 të Statutit të Komunës së Novobërdës:

F T O J

Mbledhjen e pestë të Komitetit për Komunitete e cila do të mbahet më **14.05.2019** (e martë) duke filluar në orën **10:00**.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Novobërdës;
3. Diskutim rreth emrimit të rrugëve në fshatrat e Komunës;
4. Raport nga Drejtori i qendres për punë sociale mbi numrin e rasteve sociale nga secili komunitet;
5. Raport nga Drejtori i zyrës për punësim lidhur me projektet për punësim për komunitetet;
6. Informim nga zyra për komunitete rreth aktiviteteve mujore të zyrës apo çështjeve/kërkesave të komuniteteve;
7. Të ndryshme;

Me: 08.05.2019
Në: Novobërdë



Shpresa Kqiku
Kryesuese e Komitetit për Komunitete



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e katërt e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 16.04.2019, duke filluar në orën 10:15. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Komitetit për komunitete Shpresa Kqiku, Anëtarët e Komitetit: Dobrivoje Djordjovic, Aleksander Pavic, Abdyl Gashi, Behare Jashari, Jorgovanka Filic, Nënkryetari për Komunitete Bajrush Ymeri, ZKKK Jasmina Denic, Zytarja për barazi gjinore Sadbere Vllasaliu, përfaqësuesit e UNMIK-ut, dhe përfaqësuesi i OSBE-së.

Kryesuesja e Komitetit pasi përshendeti të pranishmit tha: e hapi mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Diskutim rreth barazisë gjinore në Komunë;
3. Diskutim rreth emërimit të rrugëve në fshatrat e Komunes;
4. Diskutim rreth mundësisë për ndjekjen e kurseve të gjuhës shqipe dhe serbe-nga ana e shërbësve civil;
5. Informim nga zyra për komunitete rreth aktiviteteve mujore të zyrës apo çështjeve/kërkesave të komuniteteve;
6. Të ndryshme;

Kryesuesja i pyeti se a kanë ndonjë propozim apo pajtohen me këtë rend dite?

Pasi nuk pat diskutime aprovohet njëzëri rendi i ditës nga antarët prezent.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi pasi përshendeti të pranishmit tha: te procesverbali dhe te rendi i ditës kemi pasur për obligim për sigurinë në Komunën e Novobërdës ka qenë pikë e veçant dhe e kemi shtyr për këtë mbledhje që të diskutojmë dhe nuk është fut në rend dite, andaj është duhur që në këtë seancë qysh e kemi lënë në mbledhjen e kaluar që të jetë edhe dikush prej Policisë që të na raportoj.

Dobrivoje Djordjevic pasi përshendeti të pranishmit tha: e kam një vërjetje pasi që procesverbali nuk është perkthyer në gjuhën serbe si dhe komiteti për komunitete duhet të mbahet para mbledhjes së KPF-së, pajtohem me kolegun se kemi pasur të diskutojmë për sigurinë në Komunën tonë.

Kryesuesja tha: unë nuk kam pasur mundësi që mbledhjen ta lë para KPF-së për mbledhje të ardhshme do ta kemi parasysh, gjithashtu do ta fusim në rend dite edhe sigurinë, sa i përket procesverbalit perkthyesi nuk e ka perkthyer dhe nuk e di arsyen pasi që ai nuk është këtu.

Dobrivoje Djordjevic tha: atëherë ne nuk mundë të votojmë procesverbalin pasi që nuk e kemi në gjuhën serbe.

Abdyl Gashi tha: kishte qenë mirë që të dy procesverbalet ti kemi për mbledhjen e ardhshme. Kryesuesja tha: atëherë po besoj që në mbledhjen e ardhshme do ti kemi të dy procesverbalet.

Pika e dytë: Diskutim rreth barazisë gjinore në Komunë;

Për këtë pikë Kryesuesja ja dha fjalën Zyrtares për Barazi Gjinore Sadbere Vllasaliu.

Sadbere Vllasaliu pasi pershendeti të pranishmit tha: te nderuar të pranishëm me lejoni që ti them disa fjalë rreth barazisë gjinore në Komunën tonë si dhe të arrituarat në këtë fushë dhe sfidat me të cilat po ballafaqohemi në punën tonë të përditshme. Sa i përket avancimit të barazisë gjinore në nivelin Komunal është arritur një progres në disa aspekte të përfaqësimit gjinorë, kemi një përfaqësim të femrave të punësuar prej 30% nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, në Kuvendin Komunal kemi 40% të përfaqësuar nga femrat, gjithashtu edhe në sektoret të tjerë siç janë arsimi dhe shëndetësia të cilat e kanë kaluar këtë përfaqësim prej 50%. Po ndalem pak edhe te përfaqësimi gjinor te komitetet obligative që janë në kuader të Kuvendit Komunal ku njëri është edhe ky komitet që udhëhiqet nga një femër, që do të thotë se është arritur edhe zbatimi i ligjit për barazi gjinore në sherbimin civil pasi që është rritur përqindja e femrave të punësuar ku prej viti të kaluar deri më tani janë të punësuar 10 femra në sherbimin civil, është arritur sukses edhe në fushën e të drejtave të trashigimisë ku fal Udhëzimit Administrativ nga Qeveria e Kosovës kryesisht agjensioni për barazi gjinore ku me regjistrimin e pronës falas në emer të të dy bashkshortëve falë këtij udhëzimi kemi arritur që të kemi një përfaqësim më të madhë të femrave të cilat kanë regjistruar pronën e tyre në emer të tyre, p.sh nga numri i përgjithshëm i regjistrimit të pronave në përgjethsi kemi arritur një shifer prej 15% të cilat e kanë regjistruar pronën e tyre në emer të vetin. Kemi edhe një bashkpunim me Drejtorin e Bujqësisë ku me ndarjen e subvencioneve kemi arrit që të rritet përqindja e femrave të cilat janë pajisur me mjete të subvencionuara siç janë makina mjelse, koshere të bleteve ku kryesisht janë ndihmuar grat me asistencë sociale dhe grat kryefamiljare. Pasi që mbuloj edhe fushën e të drejtave të njërit kryesisht dhunen në familje ku është një fenomen shumë i theksuar por në Komunën tonë nuk kemi rastë shumë të theksuara por te kjo fushë kemi arrit që të kemi edhe strehimoren e cila është perkrah nga Komuna bashkarisht nga OJQ e grave që kanë dhënë një kontribut të madhë, UNMIK-u, KFOR-i. Gjithashtu kam një bashkpunim të madhë edhe me avokatin e popullit ku mbajmë takime për çdo muaj në Institucionin Komunal ku qytetarët kanë të drejtë të takohen drejtpërdrejt në zyrën time me avokatin e popullit në rast se mendojmë që i është bërë ndonjë padrejtësi, njoftimet i postojmë në faqe të Komunës ku qytetari është i njoftuar më kohë. Në kuader të ditës nderkombëtare të gruas ka qenë një nismë e marrë ku kemi veprimtarë nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme që prej datës 4 deri më 8 mars ja kanë kushtuar orën e parë mësimore si mësim për ditën nderkombëtare të gruas dhe e kemi ngritur këtë aktivitet siç janë gruas, qellimi i këtij aktiviteti ishte shenimi i ditës nderkombëtare në mënyrë gjithëpërfshirëse të sensibilizimit të barazisë gjinore në fushën e arsimit dhe të edukimit. Në kuader të kësaj fushe kemi edhe sfida me të cilat po ballafaqohemi për çdo ditë që për mua si sfida mbetet mos zbatimi i ligjit për barazi gjinore në fushën e vendimarrjes pasi që prej dhjetë Drejtori që kemi në Komunën tonë vetëm një udhëheqet nga femrat, andaj kërkoj nga instancat më të larta që të zbatohet ligji për barazi gjinore. Si sfida kemi edhe fuqizimin ekonomik të grave kryefamiljare, grave me asistencë sociale dhe kështu me radhë, te drejtoria e shëndetësisë kemi si sfida mungesën e gjinekologut, poashtu edhe mungesa e sherbimeve 24h pasi që pas orës 16 në ambulancat tona nuk funksionon asgjë, mungesa e qervedheve edhe ajo është një problem e cila krijon vështësi për femrat që dëshirojnë të punësohen, ju falenderoj për vëmendje po ju lë hapsirë edhe ju për pyetje.

Kryesuesja e hap diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi tha: e përmendet strehimoren kisha dasht me ditë sa është numri i të cilave janë strehu pasi që është një objekt mjaft i madhë, tjetra sa i përket qerdheve kishte qenë mirë që me ngrit këtë qëshetje pasi që ka hapsira që nuk shfrytëzohen ku në Llabjan është ambulanta dhe ju kishte ndihmuar shumë grave që dëshirojnë të punojnë, pasi që ka femra me fakultete por konsiderohen amvise.

Sadbere Vllasaliu tha: sa i perketet pyties për raste në strehimore për fat të mirë nuk kemi pasur asnjë rast pasi që tash ka filluar së funksionuari kjo strehimore por presimin edhe perkrahjen nga Ministra e Punës dhe Mirëqenjes Sociale, te gjitha që i thatë ju janë të sakta por barazia gjinore nuk varet vetem nga një individ andaj kerkoj nga instancat më të larta që të marrin asa në hapje të qerdheve.

Dobriwoje Djordjevic tha: kam informata se ende nuk është licencuar ajo strehimore, a ka filluar licencimi dhe financimi nga Ministria deri ku kanë arritur lidhur me këtë qështje?

Sadbere Vllasaliu tha: nuk është shumë në kompetencen time që të flas lidhur me këtë qështje pasi që kemi drejtoreshen që është Vesna Stajic e cila ka dhënë një kontribut të madhë lidhur me këtë strehimore.

Aleksander Pavic pasi pershendeti të pranishmit tha: e kam një pyetje për zyrtaren për barazi gjinore pasi që bëhet fjalë për strehimoren për femra por a ka ndonjë strehimore të ngjajshme edhe për meshkuj?

Sadbere Vllasaliu tha: sigurisht se shtepia strehuse nuk është e ndar vetem për femra, ajo është për të dy gjinit, dasht Zoti të mos kemi raste por vend ka mjaftueshme dhe dhomat janë të ndara.

Dobriwoje Djordjevic tha: e permendet perqindjen e femrave dhe meshkujve që punojnë, por sa meshkuj dhe sa femra janë në krahasim me Komunat tjera?

Sadbere Vllasaliu tha: edhe Komuna jonë është e perfert më Komunat tjera në kuader të punësimit kur flasim si ne sketorin e arsmit shendetesisë dhe sherbyesve civil kemi mjaftë të punësuar por sa i perket pozitive udhëheqëse aty na mungon perqindja.

Bajrush Ymeri pasi pershendeti të pranishmit tha: e degjova me vemendje paraqitjen e znj.Sadbere nga Zyra për Barazi Gjinore dhe po pajtohem plotësisht me atë që e tha pasi që duke marrë parasysh numrin e pergjithshëm të të punësuarve që i kemi në arsim, shendetesi besoj se qendrojmë mirë ndërsa në institucion Komunal kemi filluar gradualisht të permirësohet, aty ku është e obliguar në Kuvend Komunal dhe Komitete është e permbushur por sigurisht do të mundohemi edhe në pozita udhëheqëse. Ku kam qenë unë në pozitën e Kryetarit ka pasur munges ndërsa tash është plotësuar pasi që ka femra tzonja qe din me udhëheq, ndërsa kur jemi te qerdhet ne për herë të parë kemi formuar institucionet si parallshkoll ndërsa qerdhe nuk kemi pasi që është e vështir mu menaxhu, në Komuna tjera egzitojnë qerdhet private ku prind paguajn për fëmijt e tyre ka edhe publike por Komunat tjera kanë buxhet më të madhë por për të ardhemen ka mundësi me u shqyrto, ndërsa sa i perket strehimores lutemi që mos të kemi asnjë rast.

Abdyl Gashi tha: prioritet duhet me ju dhën qervedheve dhe në shumë Komuna funksionojnë qerdhet publiko-privat.

Pika e tretë: Diskutim rreth emërtimeve të rrugëve në fshatrat e Komunes;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Bajrush Ymeri tha: znj.Kryesuese po them fillimisht qe mledhjet e komitetit të mbahen në javën e parë të muajit në mënyr që të ketë kohë që pikat të shkojnë në KPF dhe e dyta para se ta bëni rendin e ditës konsultoni zyrratret të cilat do të raportojnë për ato pika, në këtë rast është duhur dikush nga komisioni të vijë, nuk kam qenë i kyçur direkt por e di se nuk ka mbetur shumë punë dhe jemi e vetmja Komune që nuk e kemi perfunduar ende këtë.

Behare Jashari pasi pershendeti të pranishmit tha: pasi që po bisedojm për rrugët në mahallen posht te komuniteti rom është e pa asfaltuar edhe pse e kam ngritur disa herë këtë qështje ende nuk kam marrë asnjë pergjigje edhe pse më ka premtuar D.SH.P, kamë bërë kerkes por ku është Drejtoresha që të më pergjigjet?

Bajrush Ymeri tha: e di se e keni drejtuar kerkesen aty natyrisht është duhur që premtimin e dhënë ta permbushin tash sa ka filluar sezona realizimit të projekteve andaj është mirë ty pyetni se ku kanë mbet dhe pse nuk është kryer ende kjo rrugë.

Behare Jashari tha: e kam edhe një kerkes pasi që me 8 prill për ditën e Romëve kam bërë plan që ta festojmë këtë ditë, kam derguar kerkesën Kryetarit të Komunës dhe shefes së ZKKK-së por ende nuk kam marrë asnjë përgjigje.

Abdyl Gashi tha: Kryesuese e di se nuk keni pervoj në udhëheqjen e mbledhjes dhe perpilimin e rendit të ditës, egziston pika të ndryshme ku mundë ti paraqesin kerkesat e ndryshme, disa here e kemi ngritur këtë shqetësim pasi që vendosni pika në rend dite por personat përgjegjës nuk janë prezent, nuk po e di a po i thirrni e nuk po vin apo nuk po konsultoheni para perpilimit të rendit të ditës dhe kjo është shqetësuese pasi që vetëm po debatojmë.

Dobrivoje Djordjevic tha: po nderlidhem me këtë që tha kolegu pasi që duhet të jemi më të përgjegjshëm, sa i perket emrimit të rrugëve akush nuk e din deri ku kan mrrë më punën.

Pika e katërt: Diskutim rreth mundësisë për ndjekjen e kurseve të gjuhës shqipe dhe serbe-nga ana e shërvbyesve civil;

Kryesusja për këtë pikë ja dha fjalën Shefes së ZKKK Jasmina Denic.

Jasmina Denic pasi pershendeti të pranishmit tha: unë kam kërkuar që të mbahet një kurs i tillë pasi që është i nevojshëm për të gjithë sherbyesit civil dhe kjo ka kaluar permes Drejtorisë, është OSBE-ja që e perkharr këtë projekt vete, është duke u pregaditur lista për ata që deshirojnë ta ndjekin këtë kurs.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Dobrivoje Djordjevic tha: e perkrahi këtë pikë pasi që është shumë një ide e qelluar vetëm duhet të ketë seriozitet.

Pika e pestë: Informim nga zyra për komunitete rreth aktiviteteve mujore të zyrës apo çështjeve/kërkesave të komuniteteve;

Jasmina Denic tha: kemi mbajtur takim për mbrojtjen dhe të drejtat e njeriut ku jemi munduar që të kemi perfaqësim sa më të mirë, gjithashtu siç e kam cek edhe me heret e kemi komisionin për kthim, i kemi 9 raste për ndertimin e shtepive respektivisht ne nuk kemi të drejt ne perzgjedhje por vetëm i drejtohem bordit qendror, për tri familje janë kryer të gjitha vizitat në teren ku presim që gjatë muajit maj dhe qershor të filloj edhe një rund nga ky projekt. Gjithashtu edhe organizata IOM ka një projekt për stabilizim të komuniteteve dhe janë të paraqitur pesë raste për tri raste është kryer vlersimi i tyre ky projekt është në process dhe nuk kam më shumë informata. Sa i perket të rikthyerve ka një projekt nga Ministria në bashkëpunim me zyrën e punësimit dhe zyra për kthim ju ka ndihmuar në hartimin e planit të biznesit. Gjithashtu një organizat nga Serbia në bashkëpunim me Ministrin e kthimit me ne si dhe Komunën e Kamenices dhe Ranillukit jemi duke punuara në numrin e të zhvendosurve jo të kthyerit të cilët janë të interesuar të kthehen dhe cila është ndihma që ne mund tju ofrojmë. Që nënët vite që punoj në zyrën për komunitete ne për çdo vit kemi organizuar dhe kemi ndarë ndihma ditën e romëve komunitetin romë, ose ndonjë senëich ose kemi siguruar transportin deri ku ata kan pasur që të shkojnë dhe të festojnë ditën e tyre, ne çdo herë ju kemi ndihmuar por këtë herë kërkesa ka arritur vetëm dy ditë para mbajtjes së festës së komunitetit romë.

Kryesusja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Dobrivoje Djordjevic tha: a kam një pyetje pasi që edhe në mbledhjen e kaluar kam kërkuar që të dihen emrat e perfituesve të projekteve për shtepit që do të ndertohen.

Jasmina Denic tha: ende nuk janë shqyrtuar kerkeat nuk kemi marrë asnjë pelqim për ndonjë shtepi që do të ndertojmë.

Abdyl Gashi tha: më intereson ndarja e buxhetit të projektet të komuniteti shqiptarë dhe serb dhe rom.

Jasmina Denic tha: nuk është diqka që mund të përgjigjem pasi që varet nga donatorët dhe nuk do të ishte e kuptueshme që të jap këto informata pasi që nuk është pyetje për mua.

Abdyl Gashi tha: pavarisht kësaj është në interesin tonë që ti mbrojmë të drejtat e komunitetit nëse ne njerin komunitete shpenzohet 80% e buxhetit ndersa tjetrin 20% atëher është e padrejt dhe çfarë masa mundë të merrni ju si zyre që I mbron të drejtat e komuniteteve.

Jasmina Denic tha: në punojm në bazë të planit aksional varësisht prej kerkesave, ndersa sa I perket financimit ne nuk merrmi më buxhet, ne vetem I kemi kerkesat dhe stataistikat se sa është numri I shqiptarëve dhe sa I serbve.

Aleksander Pavic tha: e kam një pyetje para disa muajve ka qenë një konkurs për zyrtar në ZKKK a është pranuar ende dikush?.

Jasmina Denic tha: nuk e di, është komisioni që punon në këtë qështje dhe nuk e di a është kryer ende.

Aleksander Pavic tha: është procedura kohore që duhet të perzgjedhet një kandidat.

Pika e gjashtë: Të ndryshme;


Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi tha: kisha diskutu për rendin e ditës, pikën për qeshtjet e siguris dhe informata rreth emertimit të rrugeve të ceket ne procesverbal që këto pika ti diskutojm në mbledhjen e ardhshme.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesja i falëndëroi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi ne ora 11:20

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse



Shpresa Kqiku
Kryesuese i Komitetit për Komunitete

